



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Valmirë Deliu	16.09.2024	20.09.2024	2024/0834

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.09.2024, OE - **“DataProgNet” SH.P.K.**- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0834, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE - **“Global CT Digital Kosovo SH.P.K.”**, Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Mirembajtja dhe Avancimi i Sistemit SERA”** me nr. të prokurimit: **“214-24-7283-2-2-1”**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar: **procedurën e hapur**, lloji i kontratës: **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **40,000.00€**.

Shënim: Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk është nxjerrë ndonjë vendim nga OSHP-ja.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (RrPP). Në vijim po paraqesim rrethanat, faktet dhe argumentet për shkeljet e dispozitave të LPP-së dhe RrPP-së.

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo- Diskriminimi
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Përmes vendimit të datës 30.08.2024, AK në këtë procedurë prokurimi ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1, Nenin 7 dhe Nenin 59 të LPP-së, pasi që komisioni i vlerësimit të ofertave nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MPB nuk ka trajtuar ofertat e OE-ve sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe LPP-së.

- Me datë 30.08.2024 nga Autoriteti Kontraktues (AK) përmes sistemit elektronik eProkurimi jemi njoftuar me Letrën standarde për tenderuesit e eliminuar dhe për tenderuesin e suksesshëm.
- Me datë 02.09.2024 përmes sistemi e Prokurimi kemi bërë kërkesë konform ligjit të KRPP-së dhe kemi kërkuar qasje zyrtare në ofertën e Operatorit Ekonomik (OE) të propozuar si tenderues i suksesshëm "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" si dhe ofertat e tenderuesve të tjerë (OE-ve) pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.
- Po në të njëjtën ditë, na është aprovuar qasja, nga dokumentet që na janë ofruar nga Autoriteti Kontraktues (AK) në ditën qasjes kemi vërejtur se OE "global CT Digital Kosovo SH.P.K" i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar deklaratë për mirëmbajtje dhe avancim, deklaratë për specifikim teknik po ashtu nuk ka ofruar as edhe një zgjidhje më të hollësishme të sistemit si Plani Dinamik, Propozimi Teknik të cilat janë të detyrueshme për çdo ofertues që të jep përgjigje me ofertë teknike, kërkesave teknike të dosjes së tenderit e sidomos të një sistemi të rëndësishëm siç është

projekti në fjalë me titull: "Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit SERA". Bazuar në faktet se nga OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" nuk është dhënë deklarata për mirëmbajtje dhe avancim, deklarata për specifikim teknik dhe mos ofrimi as edhe një zgjidhje më të hollësishme për avancim dhe mirëmbajtje të sistemit duke mos ofruar Planin Dinamik të avancimit dhe mirëmbajtjes dhe as Propozimin Teknik, kuptohet qartë se ky OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" nuk e ka të qartë se për çka ka ofertur dhe kjo me siguri ka qenë arsyeja që oferta financiare që ka dhënë OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" nuk korrespondon fare me çmimin e tregut dhe as me planifikimin e AK-së bazuar në përgjegjësinë dhe rëndësinë që ka ky sistem.

- OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" nuk i plotëson as "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2" siç janë kërkuar në dosjen e tenderit:

Listën e stafit të propozuar për këtë projekt nga OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K", nuk përputhet me kërkesat e dosjes së tenderit ku dhe po i paraqesim si ne vijim:

1. Kërkesa (1) DT: Ekspert për Zhvillimin e Bazave të të dhënave, duhet të ketë Diplomë në Bachelor i Inxhinierisë kompjuterike, Bachelor i shkencave kompjuterike ose Fakultetin Kompjuterikë me telekomunikacion, min. 3 vite përvojë pune në zhvillimin e bazave të të dhënave në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (baza e të dhënave në SQL Server). dhe të jete pjesëmarrës në së paku tri (3) projekte në zhvillimin e bazave të të dhënave.

- OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" ka propozuar për këtë pozitë staf me nivel akademik i cili nuk i përgjigjet kërkesës së dosjes tenderit, më konkretisht ka propozuar ekspert i cili është i diplomuar në fushë jo adekuate, e jo siç është kërkuar në Kërkesa (1) DT: Ekspert për Zhvillimin e Bazave të të dhënave.

2. Kërkesa (2) DT: Lista e projekteve të përfunduara Original e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projekte të realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit të përfundimtar të shërbimeve duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit.

- OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" nuk e ka ofruar listën e projekteve të përfunduara Original të vulosur dhe të nënshkruar siç është kërkuar në Kërkesa (2) DT: Lista e projekteve të përfunduara Original e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projekte të realizuara.

Andaj, bazuar në këto fakte, pasi që kemi pasur qasje zyrtare konform Ligjit të KRPP-së në ofertën teknike që ka dhënë OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" dhe pasi që kemi lexuar dhe analizuar me kujdes ofertën dhe e kemi kuptuar se OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" nuk i plotëson kërkesat dhe kriteret për të u shpërblyer me kontratë, rrjedhësisht nuk e ka të qartë natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e këtij sistemi shumë të rëndësishëm për MPB-në

AK duke shpërblyer me njoftim të dhënies së kontratës OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" ka shkelur nenin 1, nenin 7 dhe nenin 59 të LPPS-së.

Nga dokumentet që na janë ofruar nga AK në ditën qasjes edhe për OE-të e tjerë pjesëmarrëse në këtë aktivitet prokurimi, kemi vërejtur se as OE "Teretek SH.P.K." që është shpallur i përgjegjshëm (pasuksesshëm), bazuar në Letrat standarde për tenderuesit, nuk ka dorëzuar deklarata për mirëmbajtje dhe avancim, deklarata për specifikim teknik dhe nuk ka dorëzuar dëshmi lidhur me zgjidhje më të hollësishme për avancim dhe mirëmbajtje të sistemit duke mos ofruar Planin Dinamik të avancimit dhe mirëmbajtjes dhe as Propozimin Teknik, kuptohet qartë se ky OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" nuk e ka të qartë se për çka ka ofertur dhe kjo me siguri ka qenë arsyeja që oferta financiare që ka dhënë ky OE "Global CT Digital

Kosovo SH.P.K." nuk korrespondon fare me çmimin e tregut bazuar në përgjegjësinë dhe rëndësinë që ka ky sistem.

- OE "Teretek SH.P.K." nuk i plotëson as "Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2" siç janë kërkuar në dosjen e tenderit:
 1. Kërkesa (1) DT: Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE-së për periudhën e shkuar trevjeçare (2021,2022,2023) ka qenë jo më pak se 80,000.00€.
 - OE "Teretek SH.P.K." nuk i ka ofruar Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (ose në vendin e themelimit të OE-së) për vitin 2021, poashtu nuk ka ofruar qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE-së për periudhën e shkuar trevjeçare (2021,2022,2023).
- OE "Teretek SH.P.K." nuk i plotëson as "Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 9.1 & 9.2" siç janë kërkuar në dosjen e tenderit pasi që nuk ka ofruar listen e stafit Original të nënshkruar dhe vulosur.

Andaj, bazuar në këto fakte, pasi që kemi pasur qasje zyrtare konform Ligjit të KRPP-së në ofertën teknike që ka dhënë OE "Teretek SH.P.K." dhe pasi që kemi lexuar dhe analizuar me kujdes ofertën dhe e kemi kuptuar se ky OE nuk e ka të qartë natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e këtij sistemi shumë të rëndësishëm për MPB-në dhe nuk i plotëson kërkesat dhe kriteret për të u shpallur i përgjegjshëm edhe pse nuk është shpërblyer me kontratë.

AK duke nxjerrë të përgjegjshëm OE "Teretek SH.P.K." ka shkelur nenin 1, nenin 7 dhe nenin 59 të LPPS-së.

Ju njoftoj se "Sistemin SERA" e ka zhvilluar kompania "DataProgNet SH.P.K." e kontraktuar nga UNDP. Gjatë periudhës së zhvillimit dhe implementimit nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga MPB dhe UNDP, ku ju kemi përkushtuar në maksimum dhe me seriozitet të lartë profesional. Nga UNDP pas përfundimit me sukses të këtij sistemi posedojmë Referencë POZITIVE dhe bazuar në kompleksitetin e këtij sistemi planifikimi i buxhetit për 36 muaj nga Autoriteti Kontraktues nuk është i mjaftueshëm vetëm për 12 muaj, për këtë në kërkesën për rishqyrtim kemi kërkuar nga MPB të bëjnë një analizë të kërkesave për avancim dhe mirëmbajtje të këtij sistemi, të krahasoni me sistemet tjera që janë të kontaktuara në MPB dhe institucione tjera në Republikën e Kosovës dhe të ri-dizajnoni buxhetin e ri të arsyeshëm për këtë projekt për mirëmbajtje dhe avancim për 36 muaj, duke e ANULUAR këtë procedurë të prokurimi dhe duke e ri-shpallur këtë projekt përsëri me zotim të mjeteve të arsyeshme për mbulimin e pagave të stafit të kërkuar për këtë projekt.

Bazuar në kërkesat për stafin e dedikuar për këtë projekt në dosjen e tenderit:

1. Menaxheri i projektit me Diplomë Universitare, Inxhinier i Kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave inxhinierisë kompjuterike - min. 5 vite përvojë pune dhe të ketë menaxhuar të paktën një (1) projekt të natyrës së njëjte, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server)
2. Dy (2) Zhvillues i softuerit me Diplomë në Baçelor i Inxhinierisë kompjuterike ose Baçelor i shkencave kompjuterike, min. 3 vite përvojë pune programim të projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET) si dhe Ueb Shërbime WEB API dhe të jete pjesëmarrës në së paku tri (3) projekte në zhvillim softuerit të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET) dhe
3. Një (1) Ekspert për Zhvillimin e Bazave të të dhënave me Diplomë në Baçelor i Inxhinierisë kompjuterike, Baçelor i shkencave kompjuterike ose Fakultetin Kompjuterikë me telekomunikacion, min. 3 vite përvojë pune në zhvillimin e bazave të të dhënave në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft

(baza e të dhënave në SQL Server). dhe të jete pjesëmarrës në së paku tri (3) projekte në zhvillimin e bazave të të dhënave.

Nuk janë fare reale ofertat financiare nga tre (3) OE-të si në vijim, bazuar në kërkesat për stafin dhe është e pa mundur të arsyetohen vlerat për muaj që kanë dhënë secili nga këta OE në këtë procedurë prokurimi"

1. "Global CT Digital Kosovo SH.P.K" ofertën 599.98€ pa TVSH për muaj për mbulim të këtij stafi: Një Menaxher Projekti, Dy (2) Zhvillues të softuerit dhe Një (1) Ekspert për Zhvillimin e Bazave të të dhënave – që është e pa mundur të mbulohet ky staf me këtë vlerë.

2. "Cactus Sh.a" ofertën 650.00€ pa TVSH për muaj për mbulim të këtij stafi: Një Menaxher Projekti, Dy (2) Zhvillues të softuerit dhe Një (1) Ekspert për Zhvillimin e Bazave të të dhënave - që është e pa mundur të mbulohet ky staf me këtë vlerë.

3. "Tretek SH.P.K" ofertën 694.44€ pa TVSH për muaj për mbulim të këtij stafi: Një Menaxher Projekti,, Dy (2) Zhvillues i softuerit dhe Një (1) Ekspert për Zhvillimin e Bazave të të dhënave - që është e pa mundur të mbulohet ky staf me këtë vlerë.

3. "DataProgNet SH.P.K" ofertën 2,600.00€ pa TVSH për muaj për mbulim të këtij stafi: Një Menaxher Projekti,, Dy (2) Zhvillues të softuerit dhe Një (1) Ekspert për Zhvillimin e Bazave të të dhënave - që është në përputhje me vlerat e tregut.

- *Duke marrë për bazë këto fakte kërkojmë nga OSHP që të rekomandoj Autoritetin Kontraktues "Ministria e Punëve të Brendshme", që të ANULOJ vendimin e datës 30.08.2024 dhe pasi që asnjëri nga OE-të nuk është i përgjegjshëm lëndën ta kthej në ANULIM duke e ri-shpallur përsëri këtë projekt pasi të analizohet me kujdes rishikimi i mjeteve për këtë projekt në harmoni me tregun e punë, stafin e kërkuar dhe volumnin e kërkesave.*

Prandaj, duke u bazuar nga faktet dhe argumentet e lartpërmendura, ne kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që të marrë për bazë ankesën tonë, dhe të anuloh vendimin e AK-së të datës 05.09.2024 për dhënie të kontratës OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K., pasi që nuk i plotëson kriteret sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe lënda të rikthehet në ANULIM duke e ri-shpallur përsëri këtë projekt sepse nga analiza e gjithë pjesëmarrësve ne këtë procedurë prokurimit, nuk i plotësojnë kriteret për shpërbllim me kontratë dhe i tërë aktiviteti të shkon në RITENDERIM.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2) KUSHTET PER PJESEMARRJE

<p>III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:</p> <p>a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit, Aneksi 2 (Original).</p>
<p>b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.</p>	<p>b. Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentin e kërkuar i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, ta beje konfiskimin e garancionit për sigurim të ofertës dhe të vazhdojë me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit në vendin e dytë e kështu me radhë.</p>
<p>c. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë”- të jetë i lëshuar së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.</p>	<p>c. Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të operatorit ekonomik (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentin e kërkuar i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, ta beje konfiskimin e garancionit për sigurim të ofertës dhe të vazhdojë me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit në vendin e dytë e kështu me radhë.</p>
<p>d.Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se tenderuesi i përmbush “Kërkesat e pranueshmërisë”, se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile, i cili dokument duhet të jetë jo më i vjetër se 3 muaj para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë</p>	<p>d.Çertifikatë nga Gjykata kompetente-(kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Çertifikatës nga Gjykata perkatëse, tenderi i tij do të refuzohet si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar, AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe të vazhdojë me shpërblim të kontratës me Tenderuesin që është listuar në vendin e dytë.</p>
<p>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p>

a.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me Informata mbi biznesin dhe veprimtaritë. Për Operatorin Ekonomik jo rezident në Kosovë, nëse shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit të kontratës, është i obliguar që ta regjistrojnë përfaqësinë e biznesit në Republikën e Kosovës.	a.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, me informata dhe veprimtaritë e biznesit (kopje).
b.Deklarues i TVSH-së, (për kompanitë vendore).	b.Certifikata e TVSH-së (kopje).
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
a. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE-së për periudhën e shkuar trevjeçare (2021,2022,2023) ka qenë jo më pak se 80,000.00€.	a. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (ose në vendin e themelimit të OE-së) për periudhën e shkuar trevjeçare.
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
1. Menaxheri i projektit duhet të Ketë Diplomë Universitare, Inxhinier i Kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave inxhinierisë kompjuterike - min. 5 vite përvojë pune dhe të ketë menaxhuar të paktën një (1) projekt të natyrës së njëjte, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) .	1. Diploma përkatëse , CV e nënshkruar nga inxhinieri- (original), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (original) Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara.
2. Dy (2) Zhvillues i softuerit, duhet të kenë Diplomë në Baçelor i Inxhinierisë kompjuterike ose Baçelor i shkencave kompjuterike, min. 3 vite përvojë pune programim të projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET) si dhe Ueb Shërbime WEB API dhe të jete pjesëmarrës në së paku tri (3) projekte në zhvillim softuerit të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET) .	2. Diploma përkatëse , CV e nënshkruar nga inxhinieri- (original), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara.
3. Nje (1) Ekspert për Zhvillimin e Bazave të të dhënave, duhet të ketë Diplomë në Baçelor i Inxhinierisë kompjuterike, Baçelor i shkencave kompjuterike ose Fakultetin Kompjuterikë me telekomunikacion , min. 3 vite përvojë pune në zhvillimin e bazave të të dhënave në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (baza e të dhënave në SQL Server). dhe të jete pjesëmarrës në së paku tri (3) projekte në zhvillimin e bazave të të dhënave.	3. Diploma përkatëse , CV e nënshkruar nga inxhinieri- (original), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara.
4. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomikë duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku nje projekte në	4.Lista e projekteve të përfunduara Original e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projekte e realizuara, duke bashkëngjitur referencia ose

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

"DataProgNet" SH.P.K.

Tenderi i tij është administrativisht i papërgjegjshëm:

Tender tije përmban çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;

ARSYETIMI

Tenderi tij është i papërgjegjshëm dhe është refuzuar, sepse është në kundërshtim me nenin 62. Pika 2 e LPP-së sepse oferta e Juaj financiare e tejkalon në mënyrë substanciale buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit, për këtë arsye tenderi i juaj nuk është shqyrtuar dhe vlerësuar nga komisioni i vlerësimit dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtejshëm.

"Cactus" Sh.a.

Tenderi tij është i papërgjegjshëm sepse nuk ka dorëzuar:

Nuk ka dorëzuar dëshmi siç është kërkuar në Dosjes së tenderit Njoftimit për kontratë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 dhe 9.2.

Kërkesa:

1. Menaxheri i projektit duhet të Ketë Diplomë Universitare, Inxhinier i Kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave inxhinierisë kompjuterike - min. 5 vite përvojë pune dhe të ketë menaxhuar të paktën një (1) projekt të natyrës së njëjte, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

Dëshmia:

1. Diploma përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri- (original), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (original) Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit- (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara.

ARSYETIMI:


OE për këtë kërkesë ne ofertën e tij ka prezantuar Egzon Peci, të kërkesa e dosjes min. 5 vite përvojë pune shihet se personi në fjalë ka diplomuar në vitin 2022 dhe rrjedhimisht nuk e plotëson kërkesën e përvojës së punës.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta tije është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtejshëm.

DEKLARATË

Komisioni i vlerësimit në bazë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka konstatuar se për këtë tender, janë pranuar 4 oferta dhe në bazë të dokumentacionit të prezantuar në tenderët e tyre shihet se, 2 oferta janë të pa përgjegjshme dhe 2 oferta janë të përgjegjshme, dhe i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit.

Duke marrë parasysh se kriter vlerësimi ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimi më i ulët, komisioni vlerësues u përcaktua që të pranohet oferta e përgjegjshme me çmim më të ulët, e Operatorit Ekonomik "global CT Digital Kosovo SH.P.K.", i cili ka ofruar çmimin në shumë prej 25,487.28 €, prandaj Komisioni i vlerësimit i rekomandon Departamentit të Prokurimit që këtë kompani t'a shpërblejë me kontratë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrasnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹
Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik


Titulli i kontratës: "Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit SERA"

Nr. i prokurimit	214-24-7283-2-2-1
-------------------------	-------------------

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertave me TVSH, €
1.	"DataProgNet" SH.P.K.	110,448.00 €
2.	"Cactus" Sh.a.	27,612.00 €
3.	Tretek SH.P.K.	29,499.84 €
4.	global CT Digital Kosovo SH.P.K.	25,487.28 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Ministria e Punëve të Brendshme shpërblen me kontratë global CT Digital Kosovo SH.P.K. në vlerë prej 25,487.28 €€.

Data: 30/08/2024


Emri dhe mbiemri i ZPP: Agim Islami

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"DataProgNet" SH.P.K.**

Sqarim hyrës:

Autoriteti Kontraktues **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME**, ka zhvilluar Aktivitetin e Prokurimit me titull: : **"Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit SERA"** me nr. të prokurimit: **"214-24-7283-2-2-1"**,

- Publikimi i njoftimit për kontratë është bërë me datë: 16.07.2024.
- Hapja e ofertave është bërë me datë: 07.08.2024 ora: 13:30:00.
- Njoftimi mbi vendimin e autoriteti kontraktues është bërë me datë: 30.08.2024.
- Me datë: 03.09.2024, operatori ekonomik: **"DataProgNet" SH.P.K.** - Prishtinë, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim pranë **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME**.
- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME**, me datë: 05.09.2024, mori Vendim për Refuzimin e kërkesës të ri-shqyrtimit të: **"DataProgNet" SH.P.K.** - Prishtinë.
- Operatori ekonomik pas refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim nga **AK**, me datë: 13.09.2024, ka parashtruar Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim Publik.
- Operatori ekonomik: **"DataProgNet" SH.P.K.** në Ankesën e parashtruar pranë Organit Shqyrtues për Prokurim Publik, i ka paraqitur pretendimet e tij.
- Eksperti Shqyrtues pas pranimit të lëndës për ekspertizë, i ka analizuar të gjitha pretendimet e OE Ankues, dhe i ka trajtuar me kujdes duke i'u referuar legjislacionit në fuqi.

Përgjigje në pretendimet ankimore:

Operatori ekonomik **"DataProgNet" SH.P.K.** pretendon se, **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME** ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1, Nenin 7 dhe Nenin 59 të LPP-së, pasi vlerësimi i ofertave nuk është bërë në pajtim me kërkesat e përcaktuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit.

Përgjigje në pretendimet ankimore ndaj OE të rekomanduar për dhënie të kontratës "Global CT Digital Kosovo SH.P.K.":

Sipas OE ankues, **AK** ka propozuar për kontratë një OE i cili nuk ka ofruar deklaratë për mirëmbajtje dhe avancim, deklaratë për specifikacion teknik e po ashtu nuk ka ofruar zgjidhje më të hollësishme të sistemit si Plani Dinamik, Propozimi Teknik të cilat ky operator ekonomik i konsideron të detyrueshme për çdo ofertues marrë parasysh rëndësinë e projektit në fjalë. Nga qasja në dokumentet zyrtare OE **"DataProgNet" SH.P.K.** pretendon se, në mungesë të dokumenteve të lartcekura OE i propozuar për kontratë **"Global CT Digital Kosovo SH.P.K."** nuk e ka të qartë se për çka ka ofertuar, dhe se kjo është arsyeja që oferta financiare nuk korrespondon fare me çmimin e tregut dhe as me planifikimin e **AK-së** bazuar në përgjegjësinë dhe rëndësinë e projektit.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve në platformën elektronike e-prokurimi, në ofertën e OE të propozuar për kontratë ka gjetur se, është dorëzuar deklarata për specifikacion teknik e nënshkruar dhe e vulosur dhe deklarata për mirëmbajtje dhe avancim e nënshkruar dhe e vulosur (megjithëse kjo e fundit nuk ka qenë kriter për dhënien e kontratës). Ndërsa sa i përket pretendimit se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës **nuk ka ofruar zgjidhje më të hollësishme të sistemit si Plani Dinamik dhe Propozimi Teknik,**

Eksperti shqyrtues sqaron se të dy këto kërkesa nuk kanë qenë kritere për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

"DataProgNet" SH.P.K. pretendon se, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës **nuk plotëson kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional** si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 3. Një (1) Ekspert për Zhvillimin e Bazave të të dhënave, duhet të ketë Diplomë në Baçelor i Inxhinierisë kompjuterike, Baçelor i shkenca kompjuterike ose Fakultetin Kompjuterikë me telekomunikacion, min. 3 vite përvojë pune në zhvillimin e bazave të të dhënave në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (baza e të dhënave në SQL Server) dhe të jete pjesëmarrës në së paku tri (3) projekte në zhvillimin e bazave të të dhënave.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

3. Diploma përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje), Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve sqaron se, pretendimi i OE ankues për kërkesën lidhur me Ekspertin për Zhvillimin e Bazave të të dhënave nuk qëndron. OE - "Global CT Digital Kosovo SH.P.K." ka ofruar dëshmi se, eksperti i propozuar për këtë projekt është diplomuar dhe posedon titullin Inxhinier i diplomuar në teknologjinë e informacionit.

Sipas OE ankues, "Global CT Digital Kosovo SH.P.K." nuk ka plotësuar as kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional si në vijim:

Kërkesa 4. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomikë duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një projekt në lëminë e shërbimeve të ngjashme, në vlerë prej të gjitha së bashku jo më pak se 60,000.00 €, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

4. Lista e projekteve të përfunduara Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projekte të realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të shërbimeve duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit.

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimin e OE ankues se, AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME ka rekomanduar për dhënie të kontratës një OE i cili nuk ka ofruar listën e projekteve të përfunduara, origjinal të vulosur dhe të nënshkruar dhe sqaron se i njëjti nuk qëndron. Lista e kontratave të nënshkruar dhe të vulosur sipas kërkesës së AK-së është gjetur në ofertën e "Global CT Digital Kosovo SH.P.K."

Përgjigje në pretendimet ankimore ndaj OE - Tretak SH.P.K.:

OE ankues pretendon se, edhe Operatori ekonomik Tretak SH.P.K., pjesëmarrës në këtë

aktivitetet të prokurimit, nuk ka dorëzuar deklaratë për mirëmbajtje dhe avancim, deklaratë për specifikacion teknik e po ashtu nuk ka ofruar zgjidhje më të hollësishme të sistemit si Plani Dinamik dhe Propozimit Teknik.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve në platformën elektronike e-prokurimi në ofertën e OE është ka gjetur specifikacioni teknik i nënshkruar dhe i vulosur, ndërsa sa i përket pretendimeve tjera eksperti sqaron se këto kërkesa nuk kanë qenë kriteret për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Sipas OE ankues, Operatori ekonomik Tretek SH.P.K. nuk plotëson as kërkesën si në vijim:

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

a. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE-së për periudhën e shkuar trevjeçare (2021,2022,2023) ka qenë jo më pak se 80,000.00€.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (ose në vendin e themelimit të OE-së) për periudhën e shkuar trevjeçare.

Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues nuk qëndron. OE ka dorëzuar Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për vitet 2022 dhe 2023të cilat dëshmojnë qarkullimin mbi vlerën e përcaktuar nga AK-ja.

Ndërsa sa i përket pretendimit të OE ankues, se Tretek SH.P.K. nuk ka dorëzuar listën e stafit origjinal të nënshkruar dhe vulosur, eksperti shqyrtues sqaronse kërkesa në fjalë nuk kanë qenë kriter për dhënie të kontratës të përcaktuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Gjithashtu eksperti shqyrtues nuk ka gjetur se mjetet e vëna në dispozicion nga AK-ja nuk janë në harmoni me kërkesën. Për këtë aktivitet të prokurimit AK ka pranuar gjithsej 4 (katër) oferta, 3 t(ri) prej tyre nën buxhetin e përcaktuar nga AK-ja.

Mbështetur në atë që u tha më lart eksperti shqyrtues konstaton se nuk janë gjetur shkelje të nenit 1, nenit 7 dhe nenit 59 të LPP-së ashtu siç pretendon OE ankues lidhur me rekomandimin e AK-së për dhënie të kontratës.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e papabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"DataProgNet" SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit SERA"** me numër të prokurimit: **"214-24-7283-2-2-1"**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **"DataProgNet" SH.P.K.**

Valmirë Deliu

Valmirë Deliu

